

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial  
(zgjidhjet)

**P2**

FLETË PROVIMI

Data **26.01.2020**

**PËRMBAJTJA**

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK</u>- <b>PIKËT E DHËNA</b></b>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problem 5	20	
<b>Total</b>	100	

### Problem 1

Të dhënat në vijim të kompanisë PP i përkasin prodhimitarisë së 2,000 copë vazo nga deltina gjatë Korrikut. **(20 pikë)**

Materialet direkte (të gjitha materialet e blera janë shfrytëzuar):

Çmimi standarde:	€6.00 për kg të vazës
Gjithsej çmimi aktuale:	€11,200
Çmimi standard i lejuar për njësitë e prodhuara ishte	€12,000
Varianca e efikasitetit të materialeve ishte	€240 e pafavorshme

Puna direkte:

Çmimi standard është 2 vazo për orë	€24.00 për orë
Çmimi aktual për orë ishte	€24.50
Varianca e efikasitetit e punës ishte	€672 favorshme

*Kërkohet:*

- Sa është sasia standarde e materialit për prodhimin e një vazoje? **(5 pikë)**
- Sa është varianca e çmimit të materialeve direkte? **(5 pikë)**
- Sa është gjithsej çmimi aktual për punën direkte? **(6 pikë)**
- Sa është varianca e çmimit për punën direkte? **(4 pikë)**

### Zgjidhja 1

## Zgjidhja 1

- a. Kosto standarde për vazo = €12,000/2,000 = €6.00 per vazo  
Sasia standarde e materialit = €6.00/€6.00 = 1.0 kg për vazo
- b. Varianca e cmimit të materialeve = Varianca totale - varianca e efikasitetit  
= (€12,000 - €11,200) - €240 e pafavorshme  
= €560 favorshme
- c. Kosto totale standarde e punës e orëve aktuale = ((2,000/2) x €24) - €672 = €23,328  
Orët aktuale = €23,328/24 = 972 orë  
Kostot (Cmimi) totale aktuale = 972 x €24.50 = €23,814
- d. Varianca e cmimit të punës direkte = €23,814 - €23,328  
= €486 Pafavorshme

## Problemi 2

- (a) Kompania Bushati prodhon 3,000 pjesë në vit, që përdorën për tu montuar në një nga prodhimet. Kostoja për njësi për prodhimin e kësaj pjese është: **(12 pikë)**

Kosto variabile e prodhimitarisë	€36
Kosto fikse e prodhimitarisë	<u>27</u>
Kosto për njësi prodhimi	<u>€63</u>

Pjesa mund të blehet nga një furnizues i jashtëm për €60 për njësi. Nëse pjesa blehet nga ky furnizues i jashtëm, dy të tretat e shpenzimeve fikse do të eliminohen.

### *Kërkohet:*

- Çfarë është ndikimi në fitimin vjetor operativ të kompanisë që rezulton nga blerja e kësaj pjese nga furnizuesi i jashtëm? **(9 pikë)**
- Cilat shpenzime do të jenë të parëndësishme për këtë vendimmarrje? **(3 pikë)**

- (b) Kompania Saimiri përdorë sistemin e shpërndarjes së shpenzimeve gjatë përpunimit. Të dhënat në vijim janë marrë nga regjistrimet e kontabilitetit: **(8 pikë)**

Stoqet fillestare të gjysëmprodukteve (punës në progres)  
(100% të materialeve; 70% të kostove konvertuese) 120,000 njësi

Të filluara (futura) në proces gjatë periudhës 360,000 njësi

Stoqet përfundimtare të gjysëmprodukteve  
(100% të materialeve; 60% të kostove konvertuese) 80,000 njësi

### *Kërkohet:*

- Sa është numri i njësive ekuivalente të prodhimitarisë për sa u përket kostove konvertuese? **(2)**
- Sa është numri i njësive ekuivalente të prodhimitarisë për sa u përket materialeve? **(2)**
- Sa është numri i njësive për t'u llogaritur gjatë periudhës? **(2)**
- Sa është numri i njësive të kompletuara dhe të transferuara në depon e prodhimeve të gatshme gjatë vitit? **(2)**

## Zgjidhja 2

### (I)

a) Kosto e blerjes nga furnizuesi i jashtëm	(3000x€60)	€180,000
Minus: Kosto e prodhimit që eliminohet	(3000 x €54*)	<u>162,000</u>
Kosto neto shtesë e blerjes nga jashtë		<u>€ 18,000</u>

b) Pasi që 1/3 e kostove fikse të prodhimit ( $1/3 \times €27 = €9$ ) nuk mund të eliminohen, ato janë jo-relevante (pa-rëndësishme) për këtë vendimmarrje. Parandaj, kostot e ndërlidhura me prodhimin e pjesës që mund të eliminohen janë kostot variabile të prodhimit (35€/njës) dhe 2/3 e kostove fikse të prodhimit ( $2/3 \times 27 = 18€$ ), për një total prej €54/njësi. Andaj, kompania do të ketë më shumë levërdi që të prodhoj vetë njësitë pasi që kostot e blerjes (€60/njësi) tejkalojnë kostot e prodhimit që mund të evitohen (kursehen) (€54/njësi). Për 3,000 njësi, kjo kap një total prej €18,000 në vit ( $3,000 \times 6€$  kosto shtesë për të blerë = 18,000€).

### (II)

Niveli i kompletimit gjatë periudhës	Njësitë për tu llogaritur	Njësitë ekuivalente	
		Kostot e materialeve	Kostot e konvertimit
Stoqet në fillim - Njësitë e filluara në periudhën e kaluar por finalizuar këtë periudhë	120,000		
Kostot e materialeve - 100% të kompletuara		0	
Kostot e konvertimit - 70% kompletuara			36,000
Njësitë e filluara dhe finalizuara në këtë periudhë	280,000	280,000	280,000
Stoqet në fund - njësitë e filluara por të pa finalizuara në këtë periudhë	80,000		
Kostot e materialeve - 100% të kompletuara		80,000	
Kostot e konvertimit - 70% kompletuara			48,000
Totals	480,000	360,000	364,000
	c.	b.	(a)

d. Njësitë e kompletuara =  $120,00 + 280,000 = 400,000$

### Problemi 3

- (a) Në një analizë të shpenzimeve të pastrimit nga e kaluara dëshmohet se shpenzimet e pastrimit kishin një mesatare prej €0.80 për orë-punë të makinës në një nivel të aktiviteteve punuese prej 40,000 orë-punë të makinës dhe €1.00 për orë-punë të makinës për nivel të aktiviteteve punuese prej 32,000 orë-punë të makinës. (10 pikë)

*Kërkohet:*

- (1) Duke supozuar se ky aktivitetit i punëve sillet midis këtij rangu/intervali sa janë shpenzimet e pritura të pastrimit nëse niveli i aktiviteteve punuese është 37,000 orë-punë të makinës?  
(6)

- (2) Bazuar në rezultatin nga pika (a) e kësaj detyre si do t'i klasifikoni këto shpenzime dhe pse?  
(4)

- (b) Një kompani e përgadit buxhetin për prodhimin në vitin vijues. Nga informacionet në vazhdim shofim: (10 pikë)

Shitja e Buxhetuar            16,000 njësi

Stoqet në fillim            2,000 njësi

Stoqet në fund            2,100 njësi

Procesi i prodhimit është i tillë që 20% e prodhimeve janë të pa pranueshme ( dalin nga procesi i prodhimit me gabime ).

*Kërkohet:*

Sa do të jetë numri i njësive të prodhuara që të arrihet numri i njësive të shitjes së buxhetuar?

### Zgjidhja e problemit 3

(a)

1).

<u>Orët e makinës</u>	<u>Kosto për 1 orë makine</u>	<u>Kosto Totale</u>
40,000	€0.80	€32,000
32,000	€1.00	€32,000
37,000		€32,000

Shpenzimet e pastrimit pritet të jenë €32,000 në nivelin prej 37,000 orë makine.

- 2). Bazuar në të dhënat e listuara më lartë, këto shpenzime (kosto) janë fikse (jo variabile apo mikse) në natyrë; ato janë €32,000 në nivel të 32,000 orëve dhe 40,000 orëve të makinës.

(b)

16,000 njësi (buxhetuara)

+2,100 njësi (fund)

-2,000 njësi (fillim)

= 20,100 (duhet prodhuar PA GABIME) : 0.80 (niveli i saktësisë) = 25,125 njësi duhet të prodhohen total

*Prova: 25,125 njësi të prodhuara - 20% me gabime = 20,100 njësi PA GABIME*



#### **Problemi 4**

(a) DEF Co. prodhon dritare.

Informata në vijim është e zbatueshme për produktin më të njohur të tyre:

Druri	EUR 47 për njësi
Puna	EUR 20 për njësi
Shpenzime tjera të prodhimit (variable)	EUR 25 për njësi
Shpenzime administrative dhe të shitjes	EUR 12,000 për muaj
Cmimi shitës	EUR 122 për njësi

*Kërkohet:*

**Sa dritare duhet që të shesë në muaj DEF Co. në mënyrë që të ketë një fitim vjetor në vlerë prej 72,000 €? 10 pikë**

(b) Për të arritur rezultate më të mira, pronari i DEF Co. është duke marrë parasysh një blerje shtesë të pajisjeve në vlerë prej 120,000 € dhe është duke shpenzuar 2,000€ në muaj për reklamë.

Blerja e pajisjeve të reja rezulton në 20% rritje në shpenzimet e tjera të prodhimit si dhe shpenzime administrative. Pronari pret që fitimi të arrijë në 120,000EUR për një vit.

*Kërkohet:*

**Sa dritare duhet të shiten për një muaj që të arrihet fitimi sipas qëllimit? 10 pikë**

#### **Zgjidhja e problemit 4**

**(a)**

$72,000\text{€}/12 \text{ muaj} = 6,000$  (fitimi mujor)

Marzha e kontributit per njësi:  $122 - 47 - 20 - 25 = 30\text{€}/\text{njësi}$

$(12,000 \text{ kostot fikse} + 6,000 \text{ fitimi mujor})/30 = \underline{600 \text{ dritare}}$

Pra, duhet prodhuar dhe shitur 600 dritare në MUAJ për të realizuar fitimin mujor 6,000€ apo fitim vjetor €72,000.

**(b)**

$120,000\text{€}/12 \text{ muaj} = 10,000\text{€}$  (fitimi mujor)

Shpenzimet tjera të prodhimit:  $25 + (0.20 \cdot 25) = 30\text{€}$

Kostot administrative dhe të shitjes:  $12,000 + (0.20 \cdot 12,000) + 2,000 = 16,400\text{€}$

Marzha e kontributit per njësi:  $122 - 47 - 20 - 30 = 25$

$(16,400 \text{ kostot fikse} + 10,000 \text{ fitimi mujor})/25\text{€} = \underline{1,056 \text{ dritare}}$

Pra, duhet prodhuar dhe shitur 1,056 dritare në MUAJ për të realizuar fitimin mujor të dëshiruar.

## Problemi 5

ABC National prodhon dy lloje të kemikaljeve nga përzierja e njëjtë e substancave. Gjatë Janarit 2020, 600,000 litra të përbërësve janë vendosur në procesin prodhues. Prodhimi përfundimtar për atë muaj ka qenë 200,000 litra të produktit Xeon dhe 400,000 litra të produktit Neon.

Kostoja e përbashkët e prodhimit për muajin Janar ka qenë EUR 2,500,000, pra: EUR 1,300,000 për materialin direkt, EUR 150,000 për punën direkte dhe EUR 1,050,000 për SHPP. Prodhimet nuk mund të identifikohen deri në mbarimin e procesit. Produkti Xeon shitet EUR 20 për litër, produkti Neon shitet për EUR 15 për litër.

*Kërkohet:*

- (a) Shpërndani (alokoni) shpenzimet e përgjithshme (SHPP) për secilin produkt duke përdorur metodën e vëllimit fizik dhe metodën e vlerës së shitjeve përkatëse (12 pikë)
- (b) Krahasoni marzhat bruto për produktet Xeon dhe Neon duke përdorur të dy metodat e alokimit (shpërndarjes) së shpenzimeve (8 pikë)

## Zgjidhja 5

a)

Vëllimi fizik

	Litra	Koeficienti alokimit	Alokimi i kostove të përbashkëta
Xeon	200,000	200,000/600,000 ose 1/3	833,333 (2,500,000 x 1/3)
Neon	400,000	400,000/600,000 ose 2/3	1,666,667 (2,500,000 x 2/3)
<b>Totali</b>	<b>600,000</b>		<b>2,500,000</b>

Metoda e vlerës së shitjeve

	Njësi	Cmimi	Cmimi i shitjes në ndarje	Koeficienti i alokimit	Alokimi i kostove të përbashkëta
Product Xeon	200,000	20	4,000,000	4/10 ose 0.4	1,000,000 (2,500,000*.4)
Product Neon	400,000	15	6,000,000	6/10 ose 0.6	1,500,000 (2,500,000*.6)
<b>Total</b>	<b>600,000</b>		<b>10,000,000</b>		<b>2,500,000</b>

(b)

	Xeon		Neon	
	Vëllimi fizik	Vlerës së shitjeve	Vëllimi fizik	Vlerës së shitjeve
Shitjet neto	4,000,000	4,000,000	6,000,000	6,000,000
KMSH	833,333	1,000,000	1,666,667	1,500,000
Marzha bruto	3,166,667	3,000,000	4,333,333	4,500,000
<b>Marzha bruto %</b>	<b>79.16%</b>	<b>75%</b>	<b>72.22%</b>	<b>75%</b>